

## **Kundër martesës së detyruar**

### **E vendos unë se kur do të martohem!**

#### **Të premtuar, të fejuar apo të martuar pa dëshirë?**

A ke frikë se mos të fejojnë apo martojnë me zor?

A do t'i japësh fund martesës sate, por nuk di se si?

Një mikeshë a një miku i ushtrohet presion për t'u martuar me zor?

#### **Çfarë është martesë e detyruar?**

Ndonjëherë, prindërit, të afërmit ose të njohurit kërkojnë të imponojnë me presion ose dhunë atë që mendojnë se është më e mira. Mund të të akuzojnë madje se po turpëron familjen nëse nuk pranon të martohesh apo të vazhdosh një martesë. Askush nuk pyet se çfarë dëshiron ti ose vullneti yt nuk respektohet. Nëse të dy bashkëshortët nuk thonë dot "po" për një martesë me vullnetin e tyre të lirë, atëherë bëhet fjalë për një **martesë të detyruar**.

Ndërsa kur je i/e martuar, **martesa e detyruar** është kur ndihesh i/e detyruar nga familja jote që të qëndrosh në martesë, pa e konsideruar mundësinë e ndarjes.

#### **Në Zvicër, gratë dhe burrat kanë të drejta të barabarta.**

**Çdo person vendos vetë nëse do të martohet dhe kur.**

#### **Ka rrugëdalje – kërko mbështetje**

Ka **qendra të specializuara dhe këshillimore** që ndihmojnë të rinjtë në situata të vështira. Ata mund të të mbështesin dhe të të tregojnë se cilat janë hapat e mëtejshëm që duhet të ndërmerresh.

Personeli i qendrave këshillimore është i detyruar të ruajë fshehtësinë dhe nuk kontakton askënd pa miratimin tënd.

Sipas dëshirës, mund të marrësh këshillim edhe në formë anonime.

Këshillimet zakonisht janë pa pagesë.



## Shërbimet këshillimore dhe mbështetëse

**Nëse dëshiron një këshillim ose nëse do të informohesh për të drejtat e tua:**

**Qendra këshillimore për viktimat në Zvicrën Qendrore**

Luzern/Nidwalden [https://disg.lu.ch/themen/opferberatung/Opferberatung\\_inhalt](https://disg.lu.ch/themen/opferberatung/Opferberatung_inhalt)

Obwalden <https://www.ow.ch/fachbereiche/1676>

Uri/Schwyz <https://www.opferberatung-sz-ur.ch>

Zug <https://www.eff-zett.ch/angebot/opferberatung>

**Qendra të tjera këshillimore për viktimat në Zvicër** [www.opferhilfe-schweiz.ch](http://www.opferhilfe-schweiz.ch)

## Shërbime të tjera këshillimi për personat e prekur dhe specialistët:

**Qendra e këshillimit për martesat e detyruara** [www.zwangsheirat.ch](http://www.zwangsheirat.ch)

**Qendra e këshillimit për të rinjtë në rajonin tënd** [www.no-zoff.ch](http://www.no-zoff.ch)

**Asistentja/asistenti social i shkollës sate**

**Qendra e kompetencave për migrimin FABIA** [www.fabialuzern.ch](http://www.fabialuzern.ch)

## Akomodime dhe struktura mikpritëse, 24 orë në dispozicion:

**Strehim për vajzat Zyrih** [www.maedchenhaus.ch](http://www.maedchenhaus.ch) 044 341 49 45, 079 478 46 79

**Streha e emergjencës për vajza dhe djem** [www.schlupfhuus.ch](http://www.schlupfhuus.ch) 043 268 22 66

**Streha e grave Luzern** [www.frauenhaus-luzern.ch](http://www.frauenhaus-luzern.ch) 041 360 70 00

**Hostel për gratë Zug** [www.herbergefueraerfrauen.ch](http://www.herbergefueraerfrauen.ch) 041 727 76 86

**Linja e asistencës për të rinjtë** [www.147.ch](http://www.147.ch) 147

## Në rast nevoje: Nr. i Policisë 117